Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria –Vlada – Government*

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/189
Datë 13.07.2015

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4, 7, 10, 11, 16 dhe 17, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 13.07.2015 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për akreditimin e Instituti për Aftësim Profesional dhe Përkrahje të Punësimit "DITURIA" në Prizren, për periudhën 3 vjeçare, prej 13. 07. 2015 deri 13. 07. 2018 për këtë kualifikim të aprovuara:

   1.1. **Furrtari, niveli i KKK-së (III).**

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit me datë: 02.03.2015, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

- Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit;
- Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
- Raporti i Vetë-vlerësimit;
- Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

**3.** Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

**4.** Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

**5.** Vendimi i dërgohet:

- Aftësim Profesional dhe Përkrahje të Punësimit "DITURIA"; dhe
- AKK.

Nën kryetar i KD së AKK-së
Anton Gojani